

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT

Provimi i pranimit në Programin e Trajnimit Filestar për Përmbarues Gjyqësor Privat

TEZA NR. 3

25 pyetje – 4 pikë për çdo pyetje – gjithsej 100 pikë

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë? – Vetëm njëra prej alternativave është e saktë.

1. Të drejtën për të propozuar ligje e ka:

- a) vetëm Këshilli i Ministrave;
- b) Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës;
- c) vetëm deputetët.

2. Ministri:


- a) në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime;
- b) gjatë ushtrimit të funksionit nuk mund të jetë anëtar i ndonjë partie politike;
- c) mund të jetë njëkohësisht edhe kryetar bashkie.

3. Personi juridik:

- a) është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga organet e tij gjatë përbushjes së detyrave të tyre;
- b) nuk përgjigjet për dëmet e shkaktuara nga organet e tij;
- c) nuk mund të detyrohet të shpërblejë dëmet e shkaktuara nga personat fizikë.

4. Duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme:

- a) kontrata për kalimin e pronësisë së sendeve të luajtshme;
- b) kontratat për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe aktet për pjesëtimin vullnetar të tyre;
- c) vendimet e gjykatave ose organeve kompetente shtetërore që përkatesisht përbajnë fitimin ose njohjen e pronësisë mbi pasuritë e luajtshme.



5. Kontrata për shitjen e sendeve të paluajtshme:

- a) hartoher nga noteri dhe duhet të regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme;
- b) nuk është e domosdoshme të redaktohet nga noteri;
- c) regjistrimi i saj në regjistrat e pasurive të paluajtshme varet nga vullneti i blerësit.

6. Shqyrtimi i kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit zhvillohet:

- a) Nga trupi gjykues që ka dhënë vendimin e themelit, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve;
- b) Nga gjyqtari relator/kryetari i trupit gjykues që ka gjykuar çështjen në themel, në seancë gjyqësore publike.
- c) nga gjyqtari pa praninë e palëve.

7. Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbarimor gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit. Kreditori, përveç kërkesës për ekzekutim, duhet të paraqesë:

- a) titullin ekzekutiv (origjinal ose i noterizuar) dhe urdhrin e ekzekutimit (origjinal);
- b) mendimin me shkrimin të debitorit që pranon ekzekutimin e titullit ekzekutiv;
- c) një listë të pasurive të debitorit mbi të cilat mund të shlyhet kredita e tij.


8. Në rast se debitori vdes pas vënies në ekzekutim të titullit, por para se të jenë përfunduar së kryeri veprimet e nevojshme të ekzekutimit:

- a) përmbaruesi gjyqësor duhet të pushojë ekzekutimin;
- b) përmbaruesi vijon normalisht me ekzekutimin e titullit ekzekutiv pa vënë në dijeni trashëgimtarët e debitorit;
- c) përmbaruesi duhet t'u dërgoje trashëgimtarëve të debitorit të vdekur një lajmërim të ri për të ekzekutuar këta vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit.

9. Licenca e ushtrimit të veprimit tarisë përmbarimore:

- a) është dokumenti zyrtar që i jep të drejtën një individi për kryerjen e veprimit tarisë përmbarimore;
- b) lëshohet nga kryetari i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë mbi propozimin e ministrit të Drejtësisë;
- c) lëshohet nga kryetari i Dhomës, mbi propozimin e Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

10. Veprimet përmbarimore kryhen vetëm nga:



- a) përmbaruesit gjyqësorë privatë;
- b) edhe nga ndihmëspërmbaruesit;
- c) në raste të veçanta edhe nga kandidatët për përmbarues.

11. Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat:

- a) ushtrohet nga përmbaruesit, në cilësinë e personit fizik apo juridik privat (shoqëri tregtare);
- b) nuk mund të ushtrohet nga përmbarues të organizuar në një shoqëri tregtare;
- c) ushtrohet edhe nga individë të tjerë që, edhe pse nuk janë të licencuar për një veprimtari të tillë, janë të punësuar në një shoqëri përmbarimore.

12. Përmbaruesi gjyqësor privat mund të ushtrojë njëkohësisht:

- a) profesionin e avokatit, noterit dhe ndërmjetësit;
- b) detyrën e administratorit të një zyre përmbarimore, ku ortakët janë të gjithë përmbarues gjyqësorë privatë;
- c) funksionin e përmbaruesit gjyqësor shtetëror.

13. Individ, që kërkon të licencohej si përmbarues gjyqësor privat, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a) të ketë fituar statusin e ndihmëspërmbaruesit, të jetë punësuar për të paktën dy vjet në një zyrë përmbarimore, si dhe të ketë kaluar me sukses provimin e kualifikimit si përmbarues gjyqësor privat;
- b) të mos jetë dënuar ndonjëherë administrativisht për kryerjen e kundërvajtjeje administrative.
- c) të mos këtë ndonjë të afërm deri në shkallë të dytë që ushtron funksionin e përmbaruesit gjyqësor shtetëror.

14. Ndihmëspërmbaruesit gjyqësor privat:

- a) i ndalohet të punësohet në më shumë se një përmbarues;
- b) ka të drejtë të kryejë personalisht veprime që lidhen me ekzekutimin e detyrueshëm;
- c) mund të kryejë veprime për ekzekutimin e detyrimit, nën mbikëqyrjen e përmbaruesit.

15. Përmbaruesi ka të drejtë të ndërpresë ushtrimin e profesionit dhe të kalojë në statusin pasiv për arsyet e mëposhtme:

- a) zgjedhjes ose emërimit në një funksion publik;



- b) për shkak të ndjekjes së kualifikimeve profesionale afatgjata jashtë shtetit;
- c) për shkak të emigrimit të përkohshëm jashtë vendit.

16. Anëtarësia në Dhomën Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë:

- a) është fakultative, pra mbetet në vlerësimin e përmbaruesit nëse do të anëtarësohet apo jo;
- b) nuk është e detyrueshme, për sa kohë përmbaruesi ndjek programin e Trajnimit të Vazhduar që organizohet nga Dhoma;
- c) është e detyrueshme dhe përbën kusht për ushtrimin e veprimtarisë së përmbaruesit.

17. Përmbaruesi gjyqësor privat ka këto detyra:

- a) të veprojë me ndershmëri, paanësi, profesionalizëm dhe kurdoherë në interes të palës kërkuese, pa cenuar në mënyrë të paligjshme të drejtat dhe interesat e palës tjeter;
- b) të këshillojë kreditorin të mos kërkojë ekzekutimin me forcë të titullit ekzekutiv;
- c) të orientojë debitorin për veprimet që duhet të kryejë për ekzekutimin e detyrimit.

18. Në llogarinë bankare të përmbaruesit gjyqësor privat, të hapur në emrin e tij:


- a) mund të depozitohen edhe shumat monetare personale të përmbaruesit, të përfituar nga ushtrimi i veprimtarive të tjera, të ndryshme nga përmbarimi;
- b) depozitohen vetëm vlerat monetare të ardhura nga procedura përmbarimore;
- c) mund të depozitojnë shuma monetare edhe të afërm të tij.

19. Informacioni i kërkuar i jepet përmbaruesit gjyqësor privat:

- a) sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më larg se një muaj nga paraqitja e kërkesës;
- b) për aq kohë sa është e nevojshme për gjetjen dhe njoftimin e informacionit;
- c) brenda pesë ditëve pune nga marrja e kërkesës zyrtare dhe jo më vonë se dy ditë pune kur informacioni kërcohët nëpërmjet komunikimit me postë elektronike, përvèç rasteve kur parashikohet ndryshe nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

20. Kontrolli dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së përmbaruesve gjyqësorë privatë apo zyrave të përmbarimit privat realizohet:

- a) për raste të veçanta, nga Inspektorati Qendror Teknik, mbi ankimin e personave fizikë e juridikë të interesuar;
- b) nga Ministria e Drejtësisë, të paktën çdo katër vjet, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë;



- c) nga Kryetari i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, në çdo kohë, sipas vlerësimit të tij.

21. Përmbaruesi gjyqësor privat, gjatë ushtrimit të funksionit, është i detyruar:

- a) Të mbajë veshje formale;
- b) Të mbajë veshje të posaçme, sipas përcaktimeve të bëra nga organi drejtues i tyre;
- c) Veshjet e përmbaruesit, pavarësisht gjinisë së tyre, kërkojnë domosdoshmërisht mbajtjen e krovatës.

22. Veprimtaria përmbarimore e përmbaruesve gjyqësorë privatë:

- a) Përmbaruesi gjyqësor privat, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, i nënshtronhet inspektimeve dhe kontolleve të bëra nga Ministria e Drejtësisë dhe/ose nga organet e Dhomës, sipas përcaktimeve në ligjin “Për shërbimin përmbarimor privat”;
- b) Nuk i nënshtronhet kontrolllo apo inspektimeve të asnjë organi administrativ;
- c) Vetëm ministri i Drejtësisë mund të urdhërojë kryerjen e një inspektimi te një përmbarues gjyqësor privat.

23. Ushtrimi i veprimtarisë si përmbarues gjyqësor privat është e papajtueshme:

- a) Me anëtarësimin e tij në shoqatave profesionale në fushën e përmbarimit;
- b) Me formimin e një shoqërie tregtare përmbarimore, ku përmbaruesit janë cilësinë e ortakut dhe njëri prej tyre edhe administrator i saj;
- c) Me ushtrimin e njëkohshëm edhe të funksionit të avokatit.

24. Përmbaruesi gjyqësor privat ka të drejtë të kërkojë informacionin e nevojshëm për procedurat e ekzekutimit:


- a) nga persona fizikë dhe juridikë, privatë apo shtetërorë, që zotërojnë një informacion të tillë;
- b) vetëm personat juridikë publikë janë të detyruar të japid një informacion të tillë.
- c) personat privatë nuk kanë detyrim t'u japid përmbaruesve informacionin e kërkuar.

25. Përmbaruesi gjyqësor privat:

- a) në asnjë rast dhe për asnjë shkak nuk mund të refuzojë një kërkesë për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv;
- b) mund të refuzojë, për shkaqe të parashikuara në ligj, një kërkesë për venie në ekzekutim dhe/ose kryerjen e veprimeve të ekzekutimit;



- c) vlerëson vetë nëse do të kryejë veprime përmbarimore për ekzekutimin e një titulli ekzekutiv.



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Albin P. Gjergji Thaqi". The signature is fluid and cursive, with some variations in letter form.